



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2022:169187

Datë: 24.03.2024

Numri i dokumentit: 05494751

P.nr.2411/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në lëndën penale të akuzuarit K. S. nga F. K., i akuzuar për veprën penale Kanosje nga neni 181 par 3 lidhur me par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.3211/2022 të datës 20.09.2022, në seancën e shqyrtimit fillestar publike të mbajtur me datë 12.03.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Eset Rama, të dëmtuarit A. B. dhe të akuzuarit K. S me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare av. Izet Shala, me datë 15.03.2024 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 18.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari K. S., i biri i H. dhe nëna E.e gjinisë P., i lindur me, në G., me vendbanim në F. K. në rrugën “K. i L.” obj.4, me numër personal, të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i dy fëmijëve, e gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës..

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 20.06.2022 rreth orës 20.030, në F. K., i pandehuri K S., ka kanosur personin zyrtar tani të dëmtuarin zyrtarin policor A. B., lidhur me punën e tij si zyrtar hetues policor në stacionin policor në F. K., për shkakun se me datë 07.06.2022 të pandehurit i ishte shqiptuar tiketë kundervajtëse trafiku, i pandehuri vepron në atë mënyrë që përmes rrjetit social Facebook-Messenger të djalit të dëmtuarit i drejtohet me fjalë “haver ku po zatetemi sot me krye unë e ti, se atë nate qe me rrahe ne stacion te policisë unë kurr gjë borgj st’kom pas as kur n’ jetë stkom njoft e as sjom shku ne IPK as kerkun se kom dasht me kry personal me ty masi edhe ti kish pas personale me mue se mthirre n stacion kishe për deklarate e hala pa u ul m keni godit sa keni mujt, edhe tkallxov qe jom smut, e tash mka kalu krejt jom i gatshum me tu hakmerr se besën po ta jepi ja ti ja une tash e tutje, nëse je burr dil pa uniform ko me tu hakmarr edhe ma keq krejt mediat kanë me shkru besën po ta jepi se ski me rreh ma kerkun pa faj”, me ç ‘rast tek i dëmtuari ka shkaktuar shqetësim, frikë dhe ndjenjë të pasigurisë.

- *Me këtë ka kryer veprën penale Kanosja neni 181 par 3 lidhur me par 1 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 44, 69, 70, 71, 72, dhe 181 par 3 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

GJYKON

- I. Me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 900.00 (nëntëqind) Euro, të cilin dënim i pandehuri obligohet ta paguaj në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej 45 (katërdhjet e pesë) ditësh, duke llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.
- III. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 60 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV. Pala e dëmtuar A. B., me vendbanim në rrugën “B. P.” Lagjja B., Komuna e F. K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civilo-juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP/II.nr.3211/2022 të datës 20.09.2022, ndaj të akzuarit K. S. për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 181 par 3 lidhur me par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 12.03.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Eset Rama, të pandehurit K. S. me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare Av. Izet Shala dhe të dëmtuarit A. B., ku i pandehuri u njoftuan me të drejtat e tij, me aktakuzën dhe provat kundër tij. Pas kësaj prokurori i shtetit lexoj aktakuzën kundër të pandehurit.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i pandehuri u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës.

I dëmtuari ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe se e ka falur të pandehurin për veprimin e bërë.

Pas deklarimit të pandehurit, mbrojtësit të tij, të dëmtuarit dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë Gjykata konstatoj se i pandehuri ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë ne këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të

akuzuarit se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit K. S. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Kanosja nga neni 181 par.3 lidhur me par 1 të KPPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 70 të KPPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi të akuzuarit, ndërsa si rrethana rënduese gjykata nuk gjeti.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim të nenit 42 dhe 44 të KPPRK-se të akuzuarin e gjykoi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit ne pengimin e të pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne të ardhmen veçanërisht llojin e njëjte të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 €uro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.2411/22 datë 23.03.2024

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrijnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.